

236
2020

Miratohet për KKTKM

Sekretari i KKTKM

ARTA DOELLANI



PROJEKT RESTAURIMI: KISHA E SHPËRFYTYRIMIT, HEREBEL, DIBËR

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

Projektoi: Ark. Jora Vokopola

Ark. Arben Spaho

Ark. Artilla Vavako

Vendim IKTKM

Nr. 69

Dt. 19.02.2020


Dhjetor 2019

Projekt Restaurimi: Kisha e Shpërfytyrimit, Herebel, Dibër



VENDNDODHJA DHE PËRSHKRIMI HISTORIK

Kisha e Shpërfytyrimit ndodhet në fshatin Herbel, pjesë e njësisë administrative Maqellarë, Bashkia Dibër. Është pjesë e itinerarit kulturor të kishave që ndodhen në Bashkinë e Dibrës, në fshatrat përreth duke përfshirë ktu Kishën e Shën Dhimitrit dhe atë të Shën Sotirit në fshatin Kërcisht. Kisha është shpallur Monument Kulture kategori e I-rë nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës në vitin 30.05.1970. Në këtë zonë, rreth 500m larg ndodhen dhe rrënojat e kalasë së Grezhdanit, një pikë turistike shumë e vizituar. Kjo kishë i takon para pushtimit turk dhe shërben sot si altar. Përreth saj janë varret e vjetra të banorëve të krishterë që kanë jetuar në atë zonë. Është një kishë me një kapelë një nefëshe e shek. XII-XIII dikur e mbuluar me gemer.



Lidhja me qendren e fshatit

1^N


Bashkia Diber
Njesia Administrative
Maqellare
Fshati Herbel



02

PËRSHKRIMI ARKITEKTONIK DHE KONSTRUKTIV

Kisha e Shpërfytyrimit është një kishë e vogël e përbërë nga salla e lutjeve dhe nga altari. Ka një planimetri të thjeshtë katër-këndore. Në të hyet nga një portë në anën veriore, poshtë kryqit të saj. Kisha e shpërfytyrimit ka ndërtim të thjeshtë Pronaos- Naos-Abside. Absida është tre faqëshe. Muri është i ndërtuar me gurë gëlqeror lidhur me llaç gëlqereje dhe tulla. Tullat janë vendosur mes gurëve dhe mes rreshtave. Kisha është e mbuluar me çati me dy pjerrësi me tjegulla vendi. Dyshemeja është e përbërë prej pllakave të gurit të cilat tani janë të mbuluara me pllaka majolike. Çatia është e ndërtuar me res kallami dhe një rozetë të thelluar në qendër.



Skica nga Prof. Pirro Thoma

Kisha ka pasur disa faza ndërtimi dhe nderhyrjesh. Faza më e hershme është gjysëm nga lindja e apsidës, e cila i takon periudhës bizantine. Në origjinë ka qënë e mbuluar me qemerë, ndërsa sot është e rrëzuar e mbuluar me çati druri.

Në fazën e dytë kishës i është shtuar salla e lutjeve.

Në fazën e tretë kisha ruan formën e saj kompozicionale. Ndërrhyrjet konsistojnë në shtimin e këmbanarës dhe hajatit të jashtëm dhe zëvendësimin e trarëve dhe kolonave të drurit në pjesën e hajatit me kollona dhe trarë betoni. Gjithashtu është bërë e mundur që ndërtimi i këmbanarës të bëhet me beton në formë katër-këndore. Po ashtu është zëvendësuar çatia e hajatit me një çati të re e cila bie në kontrast me harmoninë kompozicionale të kishës.

Përshkrimi i i absides dhe pikturës e mbuluar nga suvaja dhe ikonstasi i cili ka ndryshuar gjatë viteve dhe ndrysimet që janë bërë.

03

NDËRHYRJET E PROPOZUARA

Në mënyrë të përmbledhur projekti parashikon restaurimin e të gjithë strukturës, duke ruajtur mundësisht të gjithë elementet e tij. Është parashikuar si fillim të realizohet sondazhi i nevojshme për themelin dhe me pas të filloje nderhyrja. Restaurimi i derës kryesore dhe F/V i të gjitha dritareve dhe fugatimin nga jashtë i objektit aty ku është i nevojshëm.

Çmontimi i çatisë, kontrolli dhe restaurimi ose zëvendësimi me trare të njejtë si origjinali i trareve për shkak të amortizimit të tyre. Zëvendësimi i pjeseve të degraduara dhe restaurimi i atyre që mund të ripërdoren. Realizimi i hidroizolimit të çatisë.

Ndërtimi i catise së hajatit duke ruajtur skemen tradicionale të saj. Gjithashtu, do të kryhet prishja e strukturës së betonit të këmbanarës dhe hajatit dhe parashikohet të ndërtohet sipas skemës origjinale të dokumentuar edhe në fotot e arkivit me material drusor. Në pjesën e brendshme është parashikuar zhveshja e objektit nga suvaja e degraduar, çmontimi i dyshemesë nga pllakat e importit dhe shtrim me pllaka guri. Tavani me res kallam do të ribëhet e me pas e gjithë sipërfaqja e brendshme e mureve do të suvatohet me llaç-gelqere të stazhonuar. Në pjesën e jashtme me rëndësi të madhe është përforsimi i themelit si dhe qepja e carjeve here me metodën shqep-qep e here me injektim sipas rastit. Gjithashtu është parashikuar ndërtimi i një drenazhi perimetralisht kishës për të evituar lageshtirën. Janë parashikuar punimet elektrike, dhe mbrojtja nga zjarri.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Specifikime të përgjithshme

1.1.1 Njësitë matëse:

Në përgjithësi njësitë matëse kur lidhen me Kontratat janë njësi metrike në mm, cm, m, m², m³, Km, N (Njuton), Ton (1000 kg) dhe gradë celcius. Pikat dhjetore janë të shkruara si ". ".

1.1.2 Qëllimi i punës:

Kontraktori duhet të bëjë kujdes në zbatimin e punimeve sipas projektit të miratuar në KKR në përputhje dhe me kushtet e kontratës si dhe të plotësojë çdo defekt gjatë punimeve. Kontraktuesi do të sigurojë që drejtuesi teknik i punimeve restauruese të jetë prezent gjatë

gjithë procesit të zbatimit të punimeve, gjithashtu personeli i kualifikuar për këto tipologji punimesh. Kontraktuesi do të sigurojë materialet, pajisjet dhe të gjitha sendet e tjera, qoftë të një natyre të përkohshme ose të përhershme, të nevojshme për zbatimin dhe përfundimin e punëve, dhe për korrigjimin e ndonjë defekti, për aq sa është e specifikuar në këtë dokument, ose mund të nxirret në mënyrë të arsyeshme gjatë zbatimit të kontratës nga Drejtuesi i Projektit më tej i quajtur Mbikqyrësi i Punimeve.

1.1.3 Grafiku i punimeve:

Kontraktuesi duhet t'i japë Mbikqyrësit të Punimeve një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas së cilave, ai propozon të punohet në restaurim deri në mbarim të punës.


1.1.4 Informacioni që duhet të sigurohet mbikqyrësit të punimeve duhet të përfshijë:

- Vizatime grafike që tregojnë rregullimin gjeneral të ambienteve të ansamblit dhe të ndonjë ndërtimi apo strukture tjetër të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim;
- detaje të vendosjes konstruksionale dhe punëve të përkohshme;
- plane të tjera që ai propozon t'i adaptojë për ndërtim e restaurim dhe përfundimin e të gjitha punëve, si dhe në vijim,
- detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar.

Mënyra dhe rregulli që janë propozuar për të ekzekutuar këto punime permanente është temë për t'u rregulluar dhe aprovuar nga Mbikqyrësi i Punimeve të restaurimit, dhe çmimi i kontratës duhet të jetë i tillë që të përfshijë çdo rregullim të nevojshëm, të kërkuar nga mbikqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të punimeve.

1.1.5 Punime të gabuara:

Çdo punë, që nuk është në përputhje me projektin e aprovuar nga KKR, dhe këto specifikime, duhet refuzuar dhe kontraktuesi duhet të riparojë çdo defekt me shpenzimet e veta, sipas projektit. Në rastet kur kontraktori i punimeve restauruese gjykon të adaptojë punime gjatë procesit të restaurimit në funksion të këtij procesi, *çdo ndryshim bëhet me aprovim të Mbikqyrësit të Punimeve dhe këto adaptime nuk duhet të prekin thelbin e projektit.*



1.1.6 Punime të rrezikshme:

Magazinimi i bombolave të gazit me presion në ambjentet e brendshme të monumentit është e ndaluar. Gjatë punimeve të rrezikshme me gazrat e ndezshme duhet mbajtur fikësejarrit sipas DIN EN 3 duhet të jetë në dispozicion pranë me vendin ku punohet.

1.1.7 Tabelat njoftuese, etj:

Asnjë tabelë njoftuese nuk duhet vendosur, përveç: Kontraktori do të ndërtojë dy tabela, që përmbajnë informacion të dhënë nga Mbikqyrësi i punimeve dhe vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhen shkruar në mënyrë të tillë, që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 100 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në shqip. Kosto e këtyre tabelave duhet të përfshihet në preventivin e punimeve.

1.1.8 Sigurimi Teknik:

Kontraktori do të zbatojë të gjitha punimet sipas standarteve Europiane dhe Shqiptare të sigurimit teknik në punë. Ai duhet të sigurojë një plan për sigurimin teknik dhe staf të kualifikuar për inspektimin e sigurimit teknik, kryerjen e instruktimit teknik për çdo punonjës dhe për çdo zë pune specifik. Gjatë punimeve të prishjes punëtorët duhet të veshin rroba të dhura të sigursë duke përfshirë syze në mbrojtjen e syrit, maska pluhuri, këpucë të sigursë, doreza të punës dhe kasketa të forta. Mbajtjen e procesverbaleve për çdo lloj aksidenti në punë dhe mbarëvajtjen e sigurimit teknik të cilin duhet tja prezantojë Mbikqyrësit çdo muaj.

1.2 Dorëzimet te Mbikqyrësi i Punimeve:

1.2.1 Autorizimet me shkrim:

"Rregullat me shkrim" do t'i referohen çdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga Mbikqyrësi i Punimeve të dërguara kontraktuesit që përmbajnë instruksione, udhëzime ose orientime për kontraktorin në mënyrë që ai të realizojë zbatimin e kësaj kontrate. Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuara, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo (duke përfshirë emra, folje, mbiemra, dhe ndajfolje), aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat,



lejet, rregullat instruksionet, emërimet, urdhëresat e Mbikqyrësit të punimeve do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.2.2 Dorëzimet tek Mbikqyrësi i punimeve:

Kontraktori duhet t'i dorëzojë Mbikqyrësit: për çdo punim shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Mbikqyrësi. Kontraktori duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çertifikata testi, kurdo që të kërkojnë nga Mbikqyrësi. Mbikqyrësi i Punimeve do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Mbikqyrësin e Punimeve dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Mbikqyrësit për të bërë këto pranime.

1.2.3 Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç është zbatuar)

Kontraktori duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet "siç janë zbatuar taktikisht" në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Kontraktori do të ruajë të gjithë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e "Vizatimeve siç është zbatuar". Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentat e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhurnohen në mënyrë të vazhdueshme dhe do t'i dorëzohen Mbikqyrësit të punimeve çdo muaj për aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mujor do të dorëzohet në kopje letër.

Vizatimet e riprodhuara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lëna gjatë gërmimeve dhe vendosjen ektakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Kontraktori gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gërmimit.

Si përfundim, kopjet e riprodhuara të Vizatimeve, "siç është zbatuar" do t'i dorëzohen Mbikqyrësit për aprovim.

1.2.4 Mostrat:



Kontraktori duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesoreve dhe tema të tjera që mund të kërkojnë me të drejtë nga Mbikqyrësi për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Mbikqyrësit.

1.2.5 Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikëqyrësit të Punimeve i cili duhet të jetë i argumentuar dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë apo origjinalitetit të veprës. Nëse materiali i propozuar për tu zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të përfunduar punimet e Kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Kontraktorit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësim do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

1.2.6 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe libreza e masave:

Kontraktori do t'i përgatisë dhe dorëzojë Mbikqyrësit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Mbikqyrësi, si dhe librezat e masave për çdo volum pune.

1.2.7 Dokumentat dhe vizatimet:

Kontraktori do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasinë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjegjësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do ta lehtësojë Kontraktorin nga përgjegjësia për punë të pakënaqëshme. Kontraktori do të marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë në bërjen e llogaritjeve të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i plotë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

1.2.8 Fotografitë e sheshit të ndërtimit:

Kontraktori duhet të bëjë fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demonstruar kushtet e sheshit përpara fillimit, progresin gjatë punës së ndërtimit dhe mbas përfundimit të punimeve.



1.3 Objekte ekzistuese

1.3.1 *Shërbimet e brendshme*: Prioritet është që para fillimit të prishjeve shërbimet komunale në zonën e prishjeve do të nxirren jashtë funksioni dhe të sigurohen që rifutja në punë e paqëllimshme të ndalohet.

1.3.2 Gjatë prishjes së elementëve të suvatuar të tilla si mure, xokol, suvaja duhet prerë pastër në kufijtë e seksionit të prishur.

1.3.3 *Betonet dhe pllakat*: Prerja me sharrë e betonit duke hapur dhe pllakat në një thellësi prej 5 centimetra nën gjendejn ekzistuese pranë. Prerjet të jenë të drejta dhe në kufijtë e shtresës që do hiqet. Matrapikët do të përdoren vetëm në pjesën e prerë dhe nuk do të përdoren në vend të sharrës.

1.4 Gërmimet:

Të mbushen të gjithë pjesët e gërmuara, kanale, gropa dhe pjesë të rrezikshme të hapura në tokë. Të tregohet kujdes gjatë gërmimeve pjesore, ato duhet të kryhen me krahë.

1.5 Hedhja dhe emërtimi i materialeve.

1.5.1 *Hedhja e materialeve ekzistuese dhe pajisjeve*:

Duke përjashtuar rastet ku tregohet në specifikime, në raste të tjera të gjitha materialet dhe pajisjet largohen dhe nuk ripërdoren. Do të bëhen pronë e Kontraktuesit dhe do të largohet nga kantieri. Titullimi për të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja, dhe pajisjeve që do të hiqen, i vishet Kontraktuesi me miratimin e Mbikqyrësit. Me autorizim nga Mbikqyrësi mund të fillojnë punimet për prishjen. Klienti nuk do të jetë përgjegjës për gjendjen, humbjen ose dëmtimit të pronës pas njoftimit të fillimit të prishjeve. Materialet dhe pajisjet nuk do të shiten nga blerësit e mundshëm apo të shiten në kantier.

1.6 Zhurma & kontrolli i vibrimeve:

Në rastet kur prishjet do të zhvillohen në ndërtesa ende në funksion; zhurma dhe dridhjet e punës intensive nuk do të lejohen brenda orarit të aktivitetit të objektit të kultit në mënyrë që shqetësimi përgjatë punës të mbahet në minimum. Koordinimi i punëve të tilla do të bëhet me Mbikqyrësin.

1.7 Kontrolli i pluhurave:

Të merren masat e duhura për të kontrolluar përhapjen e pluhurit dhe për të shmangur krijimin e një zonë të papërshtatshme përreth. Të jetë në përputhje me të gjitha rregulloret e pluhurit të vendosura nga kantieri dhe agjensitë lokale të ndotjes së ajrit. Gjatë prishjes së ndërtesave të cilat janë ende në përdorim duhet të vendosen perde pluhurit për të

mbrojtur ato zona ende nën funksion të qarkullimit të pluhurit me ajrin. Kur elementet që prishen përmbajnë materiale fibra atëherë duhet patur kujdes për të shmangur përhapjen e fibrave dhe në këtë mënyrë ndotjen. Njomja e materialit të fillë dhe përdorimi i maskave të pluhurit do të konsiderohet një masë minimale të mbrojtjes. Shpimit në materiale fibroze është i ndaluar

1.8 Mbrojtja:

1.8.1 Puna ekzistuese:

Para fillimit të punëve Kontraktuesi së bashku me Mbikqyrësin duhet të inspektojnë dhe të identifikojnë të gjitha njësitet ekzistuese të cilat do të mbahen ose të ripërdoren. Një punë e tillë ekzistuese e cila është: (a) të mbeten në vend, (b), për ripërdorim, ose (c) të mbetet pronë e Klientit, do të mbrohet duke përdorur mbulesa të përkohshme, përforcuese dhe parandaluese. Objektet të cilat do mbeten dhe të cilat janë të dëmtuara gjatë kryerjes së punës do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose të zëvendësohen me të reja me shpenzimet e Kontraktuesit. Nuk duhet të mbingarkohen elementet strukturore. Duhet siguruar mbështetje të reja dhe përforcime për ndërtimet dobësuar ekzistuese nga punimet e prishjeve. Në asnjë moment për cfarëdolloj arsye nuk duhet të rrezikohet struktura. Nëse vihet re humbja e stabilitetit të strukturës (devijime të mëdha) atëherë Kontraktuesi do të marrë masa të menjëhershme për të siguruar punimet dhe të evakujë dhe të izolojë zonën dhe të informojë Mbikqyrësin.

1.8.2 Zbritja e Materialeve:

Kur materialet ose mbeturinat zbriten nga lartësitë, kujdes duhet të merret për të parandaluar levizjet e materialeve, rënien në mënyrë të tillë që ajo krijon një rrezik për sigurinë e personelit ose të pronës publike të çdo lloji.

1.8.3 Shërbimet ekzistuese:

Telat ekzistuese elektrike dhe përcjellës që mbeten do të shkëputen me kujdes nga instalimet/kapëset e tyre (pa shkëputje), të ripozicionohen jashtë vendeve ku aktualisht punohet dhe të mbrohen nga dëmtimi. Para prishjes së punimeve kontraktuesi do të kontrollojë për vendndodhjen e shërbimeve të padukshme.

1.8.4 Dëmtimet gjatë Dimrit:



E gjithë ndërtesa duhet të jetë e mbrojtur nga dëmet e dimrit të tilla si ngrirja se tubave të ujit etj gjatë punimeve të prishjeve. Nuk duhet të punohet në temperatura më të ulëta se 5 C.

1.8.5 Punimet e Çative:

Gjatë punimeve të çative Kontraktuesi do të sigurojë ndërtesën nga kushtet e motit në çdo kohë. Material për mbulim të përkohshëm të tilla si copa për mbrojtjen ndaj motit do të sigurohen si dhe kur të kërkohet. Në përgjithësi heqja e mbulim duhet të bëhet në koordinim me fazat e punimeve të çatisë në mënyrë që kërkesa e mbulimit të përkohshëm të jetë në minimum.

1.8.6 Mbrojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jetës publike rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurimit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eliminohen në përputhje me masat paraprake të sigurimit.

Gjatë zbatimit të punimeve Sipërmarrësi duhet të vendosë dhe të mirëmbajë gjatë natës pengesa të tilla dhe drita të cilat do të parandalojnë në mënyrë efektive aksidentet. Sipërmarrësi duhet të sigurojë pengesa të përshtatëshme, shenja me dritë të kuqe "rrezik" ose "kujdes" dhe vrojtues në të gjitha vendet ku punimet mund të përbëjnë në ndonjë mënyrë rrezik për publikun.

1.8.7 Mbajtja pastër e ambjentit përreth monumentit:

Rruga hyrëse në objekt dhe ambjenti përreth tij që përdoret aktualisht si varrezë, do të mbahen pastër cdo ditë. Kontraktuesi do të marrë masat e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e objekteve përreth dhe ambjentit duke siguruar hyrje / daljen e materialeve nga kantieri.

1.8.8 Mbrojtja e pemëve:

Të gjitha pemët të cilat nuk janë të aprovuara për prerjen duhet të mbrohen nga dëmtimi gjatë tërë periudhës së kontratës. Pemët me diametër më të madh se 10 cm dhe të larta deri 1m mbi tokë (shkurret, barërat etj) do të priten, pa lejen paraprake të autoriteteve dhe të mbikëqyrësit.

1.8.9 Mbrojtja e ambjentit

Sipërmarrësi duhet të ndërmarrë të gjithë veprimet e mundëshme për të siguruar që ambjenti lokal i ansamblit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

1.9 Shërbimet e jashtme:

Duhet të mbrohen të gjitha shërbimet elektrike dhe komunale. Shërbimet komunale tregohen në vizatime. Kontraktuesi do të zbulojë të gjitha shërbimet nëntokësore në kantier para fillimit të punimeve të gërmimit. Lejet e gërmimit do të merren nga furnizuesit e shërbimeve dhe një kopje do të dorëzohet tek Mbikqyrësi. Kur heqja e shërbimeve ekzistuese dhe kalldrëmit është specifikuar apo të nënkuptuara, do të sigurohen barrikada të miratuara, mbulimin e përkohshëm në zonat e ekspozuara dhe lidhje të përkohëshme për sistemet elektrike dhe të shërbimeve komunale. Distanca e nevojshme e punës të sigurt nga lart për linjat e tensionit të lartë do të caktohet dhe të miratohet me kompaninë e shpërndarjes elektrike. Një kopje e kësaj leje do të lëshohet nga Mbikqyrësi. Kontraktuesi do të ketë kohë të mjaftueshme para fillimit të punimeve, të informojë autoritetet përkatëse në mënyrë që mund të ndërmerren hapat e nevojshëm për të bërë të mundur spostimin e kablllove.

1.10 Skelëria:

Ië gjitha skelat duhet të projektohen dhe të montohen në përputhje me standardet e kërkuara. Vetëm punëtorët me përvojë dhe kompetent do të montojnë skelerinë në lartësi. Kontraktuesi do të sigurojë që çdo modifikim të nevojshëm të skelave gjatë rrjedhës së punëve, do të pranohen nga montuesit e skelave në mënyrë që skela do të mbetet i përshtatshëm për qëllimin për të cilin janë të dedikuara. Nënshkrimi i miratimit të skelës do të bëhen i dukshëm në çdo pikë të hyrjes në nivel të tokës tek skela. Punimet në skelë të paautorizuara është rreptësisht e ndaluar. Duhet patur kujdes që ngarkesa e cdo grumbulli mbeturinash në skelë nuk e duhet ta kalojë ngarkesën e lejuar sipas projektimit. Ngarkesat maksimale të lejueshme të skelave do të jenë qartë të dukshme në të gjitha pikat e hyrjes në nivelin e tokës. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hedhjen aksidentalisht të mbeturinave nga platforma. Skela metalike e tipit mbështetës, në përputhje me standardet dhe rregullat lokale, duke përfshirë furnizimin e mbështetëses, mirëmbajtjen, montim, ankorimit, çmontimin etj 15cm nga dyshemeja do të vendosen në të gjitha nivelet. Copë mbrojtëse ndaj motit ose të paktën rrjetë mbrojtëse duhet të vendoset në pjesën e jashtme të skelës.

1.11 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Kontraktori, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatëshme për t'i mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyrësi i Punimeve në çdo kohë.

1.12 Pastrimi përfundimtar i zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Kontraktori duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të çdo lloji dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme.

SEKSIONI 2. PUNIME PRISHJEJE-ÇMONTIMI DHE PASTRIMI

2.1 Të përgjithshme

Punimet e prishjes dhe çmontimit në restaurim janë një proces i rëndësishëm, në të duhet të marrin pjesë punëtorë të specializuar të cilët duhet të mbikëqyren në çdo rast nga drejtluesi teknik i punimeve. Nëpërmjet prishjes evidentohen gjurmë të reja të cilat sjellin dëshmi të reja lidhur me monumentin të cilat duhet të dokumentohen. *Materialet e nxjerra nga çmontimi pas seleksionimit nëse nuk janë të dëmtuar ripërdoren.*

REFERENCAT: Publikimet e listuara më poshtë formojnë një pjesë të këtij specifikimi të referencave të zgjeruara. Botimet që janë të referuara në tekst janë të përcaktuara vetëm për gjërat bazë.

2.1.1 Ligjet dhe Normat e aplikuar shqiptare:

- Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me parimet e "Kartës Shqiptare të Restaurimit", VKM. Nr.426, 13 Korrik 2007.
- Ligji Nr.9048, datë 04/07/2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", (I ndryshuar)

DORËZIMET : Dorëzimet në vijim:

- 2.1.2 *Deklarimet:* Dorëzimi i procedurave të propozuara të prishjeve dhe heqjes së materialeve tek Mbikqyrësi për miratim, para se puna të fillojë. Procedura do të sigurojë heqjen e kujdesshme dhe sistemimin e materialeve në koordinim me veprat e tjera në proces, dhe një orar për mospengimin e shërbimeve komunale, të gjitha lejeve të nevojshme nga kompanitë e furnizimit e të shërbimeve. Një përshkrim të detajuar të metodave dhe pajisjeve që do të përdoren për çdo punë dhe të vazhdimet së punëve që kryhen.
- 2.1.3 *Kushtet e mbikqyrjes:* Në rastet kur prona fqinje mund të dëmtohet nga punimet atëherë Kontraktuesi duhet të kryejë me shpenzimet e tij një studim të detajuar të gjendjes së pronës fqinje përfshirë këtu edhe dokumentacionin fotografik një kopje e të cilit duhet të paraqitet dhe të miratuar nga Mbikqyrësi para fillimit të punimeve.

KËRKESAT: Puna përfshin çmontimin dhe largimin e të gjitha materialeve të diktuar ose të specifikuar. Punimet e prishjeve nuk do të fillojnë deri sa autorizimi të merret nga Mbikqyrësi. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishja, përveç nëse tregohet apo të specifikohet ndryshe, do të largohen nga kufijtë e sheshit të ndërtimit. Mbeturinat do të hiqen nga kantieri çdo ditë, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Mbikqyrësi; akumulimi i materialit të tillë është i ndaluar. Materialet të cilat nuk mund të hiqen brenda ditës do të ruhen në mënyrë të përshtatshme në zonat e përcaktuara. Nëse Kontraktuesi identifikon kalbësira në dru gjatë punimeve të çmontimit ai do të marrë masat e duhura për sigurinë e shëndetit. Njoftohet menjëherë Mbikqyrësi dhe i propozohen masa të përshtatshme për miratim. Kontraktuesi duhet të paraqesë prova për asgjësimin e duhur të materialeve me kërkesë të Mbikqyrësit.

2.2 Pastrimi i kantierit

2.2.1 *Pastrimi i kantierit:*

Në fillim të kontratës, për sa kohë që ajo nuk ka ndryshuar, kontraktori duhet të heqë nga territori i punimeve të gjitha materialet organike vegjetare dhe ndërtuese, dhe të djegë të gjitha pirgjet e mbeturinave të tjera.

2.2.2 *Mbrojtja e objekteve, rrethimeve dhe strukturave:*

Gjatë kryerjes të punimeve prishëse, kontraktuesi duhet të marrë masa që të mbrojnë objektet dhe strukturat që gjenden në afërsi të objektit, ku po kryhen këto punime prishëse.

Skeleri çeliku në kornizë dhe e lidhur, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parrakë vertikale, me lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

2.3.2 Mbikqyrja

Kontraktori duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperiencë, të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe të mbikëqyrë punën për ngritjen e skelave në kantier.

2.3.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objekteve.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë statike të objektit.

Kur prishja e elementeve të ndërtesës nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme. Elementët e drurit mund të hidhen nga lart, vetëm kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjetër të stukturës. Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë.

Në përgjithësi, puna e çmontimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme, pa ndërhyrë në elementët bazë struktural. Punë të kujdesshme do të bëhen për të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira. Seksionet të tjera që do të prishen do të ndahen dhe do të ulen në tokë nën kontroll.

SEKSIONI 3. NDËRHYRJE KONSERVUESE DHE RESTAURUESE

3.1 Të përgjithshme

Çdo ndërhyrje e propozuar duhet të jetë në përputhje me Projektin e miratuar në KKR si dhe parimet e "Kartës Shqiptare të Restaurimit" – VKM Nr.426 on 13 Korrik 2007.

Për këtë, duhen evituar mbingarkesat nga të gjitha anët e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshtë, duhet pasur kujdes që të parandalohet shpërndarja ose rënia e materialeve, ose të projektohet në mënyrë të tillë, që mos të përbëjë rrezik për njerëzit, strukturat rrethuese të çdo lloji.

Duhet bërë kujdes nga kontakti me kabllot elektrik.

2.2.3 Mbrojtja e vendit të pastruar:

Kontraktori duhet të ngrejë rrjetë të përshtatshme, barriera mbrojtëse, në mënyrë që, të parandalohet aksidentime të personave ose dëmtime të godinave rrethuese nga materialët që bien, si dhe të mbajë nën kontroll territorin, ku do të kryhen punimet.

2.3 Punime prishjeje

2.3.1 Skeleritë:

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastet e kryerjes së punimeve në anë të rrugës ku ka kalim si të kalimtarëve, ashtu edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet një rrethim i objektit, si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri celiku të tipit këmbalec, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj. Në një lartësi mbi 12 m, elementët horizontalë duhet të kenë parrakë vertikale, më lartësi min.15 cm si dhe mbrojtjen me rrjetë.

3.2 Shpjegim i terminologjisë

"Konservim" janë të gjitha masat e ndërmarra që nuk kërkojnë ndërhyrje direkte në vepër siç janë krijimi i kushteve mjedisore (lagështi relative, temperaturë, pastërti nga ndotja atmosferike, mbrojtja nga pluhurat, dëmtimi biologjik dhe fizik në fonde, ekspozimi dhe transporti), si edhe ndërhyrjet kimike direkt në objekt apo vepër, me qëllim parandalimin e çdo lloj dëmtimi.

"Ndërhyrje" është tërësia e masave të ndërmarra dhe operacioneve të kryera në vepër, me qëllim ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe nxjerrjen në pah të vlerave të saj.

"Restaurimi" është vlerësimi i thelbit origjinal të monumentit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme dhe nxjerrjen në pah të vlerave të tyre.

Këshillat mbi Parimet dhe Metodatat të cilat ofrojnë udhëzimet e propozuara të ndërhyrjeve restauruese duhet të lexohen së bashku me këtë dokument.

3.3 Ndërhyrjet në "monumentet e kulturës"

Në disa raste nevojat për konservim duhet ti paraprijnë atyre të vendosjes në siguri, në vazhdim nuk është e nevojshme të rregullohen nivelet e sigurisë të një ndërtese historike me ato ndërtesave të reja por është e mjaftueshme që nivelet e sigurisë të përmirësohen krahasuar me ato para ndërhyrjes.

Teknikat e ndërhyrjeve që do përdoren në monumentet e kulturës duhet të respektojnë karakteristikat historike, artistike, arkitektonike dhe shpërndarjen e tyre. Kjo do të thotë që përmirësimi duhet të realizohet pa prodhuar modifikime substanciale në sjelljen e strukturës dhe ndërtesës duke përdorur për sa është e mundur teknika ndërhyrje dhe metodologji operative tradicionale, konservim të materies, kushteve fizike dhe morfologjike. Teknika dhe materiale me karakter reversibël edhe pjesor që përdoren në mënyrë diskrete, jo evazive dhe në koherencë me llogjikën konstruktive të strukturës ekzistuese.

SEKSIONI 4. SPECIFIKIME TEKNIKE SIPAS ZERAVE TE PROJEKTIT

4.1 Pastrim nga bimësia e ulët+ injektim i solucionit për tharjen e bimëve të këqija

Ky çmim përfshin pastrimin e strukturës së Kishës nga bimësia e ulët. Vegetacioni i ulët ka nevojë për ndërhyrje në të dyja ciklet e zhvillimit, pranverë dhe vjeshtë. Trajtimi i tij do të bëhet në bazë të aspektit të zhvillimit. Në strukturat ku vegetacioni është i rrallë do të përdoret pastrimi mekanik i tij, duke eliminuar vegetacionin me githë rrënjë.

Pas eliminimit përfundimtar të vegetacionit, është e nevojshme që të bëhet fugatimi i strukturave. (si realizohet ky proces, do të trajtohet në paragrafët pasardhës).

Në rastet kur trugu/kërcelli ka diametër më të madh se 4 cm atëherë pasi të bëhet prerja do të përdoret mënyra e injektimit të herbicidit si tek pemët e larta.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

4.2 Transport materiale ndërtimi, dheu dhe mbeturina me auto deri në 10.0 km (2.37/5b)

Materialet që do hiqen nga objekti apo akumulimi i inerteve, dherat e lëvizura, do të hiqen në mënyrë manuale me lopatë dhe largimi i tyre nga kantieri deri te mjeti i transportit do të bëhet me karro dore. Dherat e pastruar si dhe materialet inerte do të largohen nga kantieri me automjet. Transporti i çdo materiali nga Kontraktori, do të bëhet me makina të përshtatshme, të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri.

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia deri në 10 km larg nga kantieri.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m³.

4.3 Nështresë zhavorri

Ky zë përfshin blerjen e materialit të zhavorit si dhe vendosjen në vepër. Shtresa e zhavorit është parashikuar të vendoset në trotuarin perimetralisht kishës. Do të bëhet ngjeshja dhe nivelimi i shtresës.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

4.4 Shtresë betoni C12/15 (10 cm)

Shtresa e betonit do të vendoset në pjesën e hajatit. Ky zë përfshin të gjithë materialin e nevojshëm betoni të varfër C12/25 për shtrim, transportin dhe vendosjen në vepër.

Përbërësit e betonit duhet të përmbajnë rërë të larë ose granil, ose përzierje të të dyjave si dhe gurë të thyer. Të gjithë agregatët duhet të jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e aggregateve duhet të jetë me formë këndore dhe jo të rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet të kenë çertifikatën që vërteton vendin ku janë marrë ato. Beton marka 150 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granil deri në 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 260 kg, rërë e larë 0,44 m³, granil 0,70 m³, ujë 0,18 m³.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

4.5 Trotuar me pllaka guri pa bordurë

Shtrimi i pjesës së oborrit si rrugicë deri te kisha do të bëhet me pllaka guri. Këto punë do të bëhen në këtë mënyrë:

Përmbi bazën do të vendohet një shtresë rëre me një trashësi maksimale prej 5 cm mbi të cilën do të vendosen pllakat e gurit. Shtresa e rërës duhet të jetë me kokrriza 2/5 mm deri 0/4 mm. Ajo do të rrafshohet dhe mbi atë duhet të vendosen pllakat e gurit.

Mbas vendosjes së pllakave ata me një makinë të posaçme do të tundën në atë mënyrë që të arrihet një rrafshësi perfekte. Më në fund fugat e pllakave do të mbushen me një rërë të imët 0/1 mm në atë mënyrë që pllakat të lidhen më së miri njëra me tjetrën dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e pllakave të gurit.

Karakteristikat e pllakave të gurit duhen marrë prej prodhuesve. Ato variojnë si në trashësi ashtu edhe në dimensionet e tjera. Po ashtu edhe ngjyrat e tyre janë të ndryshme. Projektuesi së bashku me Mbikqyrësin e punimeve duhet të bien në marrëveshje ndaj modelit, dimensioneve dhe ngjyrës së pllakave, dhe të sigurohen që janë të ngjashme me ato ekzistuese.

Në figurën e mëposhtme paraqiten shtresat për këtë tip shtrimi.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

4.6 Gërmim e mbushje dheu për themele, h = 1.5m

- Mbrojtja e punimeve të dheut

Tek punimet me dheun duhet nga njëra anë të mbrohen njerëzit, të cilët nuk janë të përfshirë në ndërtimin e projektit, e nga ana tjetër duhet të mbrohen njerëzit e inkuadruar në realizimin e projektit. Gjithashtu, duhet mbrojtur gropa e hapur për themelet.

Mbrojtja e njerëzve të painkuadruar duhet bërë në atë mënyrë që të bëhet rrethimi (me gardh, rjetë gabiant etj.) i cili nuk i lejon ata (sidomos fëmijët) të rrezikohen. Gjithashtu, duhet vendosur tabela paralajmëruese me të cilën ndalohet kalimi i rrethimit nga persona që nuk punojnë në projekt. Gropa dhe njerëzit që janë duke e punuar atë, duhen mbrojtur ndaj shembjes. Shkalla e ledhit e çdo grope duhet të jete min.45 grade deri max. 60 grade.

M.q.se jemi në zona me sigma të ulet të cilat në kontakt me ujin e humbin stabilitetin, atëherë dheu dhe pjesët e gërmuara, si dhe pjesët e themelit që do të perforcohet duhet të ruhen duke e përforcuar me armatura mbajtëse sipas KTZ.

Gërmimi do të bëhet i alteruar çdo 1m, pasi bëhet gërmimi dhe betonimi 1m po 1m jo. Pasi gërmohet në njërën anë dhe nën themel në thellësinë e treguar në projekt me gjeresi 1m nga jashtë, vendosen armatura përforcuese nën themeld vetëm pas kësaj mund të vazhdohen me gërmimin nga brenda dhe me murin e gurit.

- Gërmime për baza dhe themele

Gërmimi i dheut për perforcimin e themeleve, deri në thellësinë e treguar ne prerjet perkatese ne projekt, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të thatë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj,) duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve, dhe pjesëve me volum deri në 0.30 m3, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në përgjithësi etj.

- Mbushjet

Shtresë me gurë dhe copa tulle të zgjedhura, në shtresa të ngjeshura mirë, të pastruara nga pluhuri, suvaja dhe materialet organike, që rezultojnë nga prishjet e përshkruara në artikujt e mësipërm. Të gjitha materialet që rezultojnë nga prishjet, do të kontrollohen më parë nga Supervizori dhe ripërdorimi i tyre do të autorizohet nga ai.

- Përdorimi i materialit të gërmuar

Materiali i përshtatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdorën për rimbushje dhe nivelim. Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

- Mbushja rreth strukturave

Materiali duhet vendosur në mënyrë simultane në të dyja anët e mbajtëses mur apo shtyllë. Mbushjet e mëvonshme të nxirren nga një material i aprovuar nga Supervizori, duke hedhur me shtresa me trashësi 150 mm me ngjeshje.

Ky çmim është $\text{Lekë}/\text{m}^3$.

4.7 Konsolidim i kreut të murit me 1-2 rreshta gur

Punimet realizohen në plan (jo vertikalisht) në pjesën më të sipërme të murit.

Në pjesët ku ka mungesa materialit të gurit do të bëhet mbushja e tyre me gurë (maksimalisht 1-2 rreshta) derisa sipërfaqja e sipërme të jetë e niveluar.

Ky çmim është për njësi $\text{Lekë}/\text{m}^3$.

4.8 Sondazh për themele

Ky çmim prashikon sondazh për themele në zonat ku do të bëhet gërmim dheu për të evidentuar gjurmët e strukturës për të verifikuar themelet nëse janë të mjaftueshme për muratura të tilla dhe nëse çarjet vertikale vazhdojnë deri në bazament. Sondazhet do të bëhen në pikat e paraqitura në fletët teknike.

Gjatë sondazhit për themele dhe gjatë procesit të gërmimit i pranishëm në terren duhet të jetë specialisti restaurator.

Ky çmim është për njësi $\text{Lekë}/\text{m}^3$.

4.9 Çmontim çatie

Përpara fillimit të punimeve të restaurimit të çatisë, kryhen punimet e çmontimit të elementëve të mbulesës në pjesën e narteksit. Punimet duhet të kryhen me kujdes, për të zbuluar ndonjë element apo gjurmë të fazave më të hershme.

Do të bëhet heqja e kujdesshme e tjegullave dhe seleksionimi i tyre, të cilat do të depozitohen me kujdes për tu ripërdorur, duke i sistemuar sipas grupimeve në terren. Tjegullat në gjendje të mirë që do të ripërdoren, lahen dhe pastrohen me furçë të ashpër.

Proçesi do të vazhdojë me heqjen e shtresës hidroizoluese aty ku ka (nëse ka), e më pas petavrave me material drusor të degraduar. Do të hapet një hapësirë e përshtatshme për të mundësuar kontrollin e materialit drusor të çatisë, trarë / binarë etj. Materialet e padëmtuara të cilat do të qëndrojnë në çati, do t'u nënshtrohen përkujdesjeve konservuese, ndërsa ato që kanë pësuar amortizim ose janë të deformuar dhe ndikojnë në konstruksionin e çatisë, do të hiqen dhe do të ruhen për zëvendësimin e tyre me material të shëndoshë sipas përmasave, materialit dhe teknikës origjinale të elementit.



Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për zbulimin dhe pastrimin e çatisë. Heqja e tjegullave, zbritja në tokë, seleksionimi i tyre për ato që do të përdoren dhe që janë të rregullta. Çmontimi i shtresës së petavrave të drurit e cila duket shumë e dëmtuar. Gjithashtu në çmim përfshihet heqja e lëndës drusore nga çatia dhe seleksionimi i saj në raste se mundet të përdoret si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë fund heqjes.

Mbasi bëhen këto punime paraprake, në prezencë të kontraktorit, dhe mbikëqyrësit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë që do të përdoret brenda kushteve teknike dhe për pjesën e dëmtuar që do të hidhet. Në çmim përfshihet edhe transporti i mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m² çati në plan .

4.10 Përgatitje dhe vendosje lëndë e sharruar pishe (kolonat e drurit mbi sofat)

Ky zë përfshin përgatitjen dhe vendosjen e lëndës së sharruar të drurit për ndërtimin e këmbanarës dhe strukturës së drurit në hajat. Lënda e drurit duhet të jetë trajtuar me dizinfektues ndaj krimbave e kërpudhave si dhe me do të trajtohen për rritjen e rezistencës ndaj agjentëve atmosferike. Trarët, në pjesën mbështetëse të murit do të lyhen me zift. Lënda duhet të jetë e cilësisë së lartë dhe përpara se të vendosen në objekt lënda duhet të kontrollohet nga mbikëqyrësi i punimeve.

Përpara ripërdorimit të gjithë elementet do të vendosen duhet të trajtohen me antimolë e vaj lini. Materiali, ngjyra dhe dimensionet e elementëve të rinj duhet ti referohen projektit dhe për çdo paqartësi të dakortësohet me supervizorin e punimeve. Në objekt, në bashkëpunim të mbikëqyrësit të punimeve dhe projektuesit të evidentohet dhe detajohet teknika e montimit të brezave /arkitrave të rinj.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m³.

4.11 Konsolidim i kreut të murit me 2cm llaç gëlqere 1:3

Konsolidimi do të realizohet duke pastruar kreun e murit nga llaçi i degraduar, larje dhe injektim (me rënie të lirë). Kreu i murit do të pastrohet dhe nivelohet me llaç gëlqere me trashësi rreth 2 cm. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet të bëhet për përgatitjen e sipërfaqes së dëmtuar të murit, pastrimin, larjen me ujë, konsolidimin e murit të dëmtuar me teknikën e ndërthurjes. Në çmim përfshihet blerja e materialeve, transporti i tyre në objekte dhe çdo punë që lidhet me përfundimin e saj. Në çmim përfshihet edhe transporti i

mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.
Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

4.12 Themele betoni C – 12/15 (në murin perëndimor)

Themelet të kryera prej betoni të dorëzuar për m³ dhe të pastruar në shtresa të trasha të vibruara mirë, me dimensione dhe formë të treguar në vizatimet teknike përkatëse, duke përfshirë kallëpet, formën e punës, mbështetjen dhe të gjitha kërkesat për të kompletuar punën me cilësi.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

4.13 Konsolidim i kreut të murit dhe mbulim pllaka guri (muri i sofatit)

Konsolidimi i kreut të muraturës në sofat ka për qëllim të mbrojë muraturën nga infiltrimi i ujërave të shiut në brendësi të saj. Punimet realizohen në plan (jo vertikalisht) në pjesën më të sipërme të murit.

Në pjesët ku ka mungesa materiali të gurit do të bëhet mbushja e tyre me gurë (maksimalisht 1-2 rreshta) derisa sipërfaqja e sipërme të jetë e niveluar. Pas nivelimit të murit do të bëhet vendosja e pllakave të gurit mbi të. Fugat e krijuara mes pllakave të gurit të shtruar horizontalisht mbi murin e gurit të rrethimit, do të trajtohen me llaç gëlqere 1:3 në mënyrë që ujerat të mos depërtojnë në brendësi të murit.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m³.

4.14 Restaurim çati me rasa guri (absida)

Fillimisht do të bëhet çmontimi i kujdesshem i rrasave të gurit duke shpëtuar ato që janë të padëmtuara e të forta konstruktivisht duke i seleksionuar me kujdes për tu ripërdorur më vonë.

Do të bëhet pastrimi nga mbushjet e tepërta dhe llaçi duke depërtuar deri në shtresën e fundit të gurit. Më pas do të realizohet fugatimi i zonës me llaç gëlqere e më pas do të vendoset një shtresë llaçi horasan para se të vendosen rrasat e gurit.

Ky çmim është për Lekë/ m².

4.15 Shtresë me pllaka guri

Shtrimi i pjesës së brendshme të kishës edhe hajati do të bëhet me pllaka guri.

Këto punë do të bëhen në këtë mënyrë:

Pas çmontimit të pllakave ekzistuese përmbi bazën do të vendoset një shtresë llustër çimento 1:2 e cila do të realizojë edhe nivelimin e sipërfaqes dhe mbi të cilën do të vendosen pllakat e gurit. Mbas vendosjes së pllakave do të realizohen edhe fugat e në atë mënyrë që pllakat të lidhen më së miri njëra me tjetrën dhe të përforcohet/stabilizohet shtresa e pllakave të gurit.

Karakteristikat e pllakave të gurit duhen marrë prej prodhuesve. Ato variojnë si në trashësi ashtu edhe në dimensionet e tjera. Po ashtu edhe ngjyrat e tyre janë të ndryshme. Projektuesi së bashku me Mbikqyrësin e punimeve duhet të bien në marrëveshje ndaj modelit, dimensioneve dhe ngjyrës së pllakave, dhe të sigurohen që janë të ngjashme me ato ekzistuese.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

4.16 Skelë tubo tavani -8m

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një sektor kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Ky çmim përfshin ndërtimin skeles brenda narteksit të kishës për të realizuar të gjithë punimet në muraturë dhe konstruksionin e çatisë. Në mënyrë që skela të krijojë siguri duhet të jetë metalike, tubolare e kolauduar brenda vitit të fundit.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

4.17 Skelë tubo fasade -8m

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një sektor kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar

skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Gjatë kryerjes së punimeve meqënëse kemi një territor që përdoret vazhdimisht nga kalimtarët ndoshta edhe të makinave, duhet të merren masa që të bëhet veshja e pjesës së sipërme të skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Ky çmim përfshin ndërtimin skeles përgjatë gjithë fasadës jashtme të objektit për të realizuar të gjithë punimet në muraturë, konstruksionin për mbulimin provizor si dhe konstruksionin e catise. Në mënyrë që skela të krijoj siguri duhet të jetë metalike, tubolare e kolauduar brenda vitit të fundit.

Ky çmim është për njësi Lekë/ m².

4.18 Bojë vaji sipërfaqe metalike

Ky zë përfshin stukimin dhe zmerilimin e elementëve prej hekuri duke përdorur stuko të përshtatshme për përgatitjen e sipërfaqeve për lyerjen me bojë vaji. Lyerja e sipërfaqeve metalike është parashikuar në lyerjen e të gjitha kangjellave metalike të dritareve.

Lyerje e elementeve prej hekuri, me bojë të përgatitur fillimisht me një dorë minio plumbi ose antiruxho ose në formën e vajit sintetik, me dozim për m², 0.080 kg.

Lyerje me bojë vaji sintetik për sipërfaqe metalike, me dozim për m²: bojë vaji 0.2 kg dhe me shumë duar për të patur një mbulim të plotë dhe perfekt të sipërfaqeve si dhe çdo gjë të nevojshme për mbarimin e plotë të lyerjes me bojë vaji në mënyrë perfekte.

Ky çmim është për Lekë/ m².

4.19 Suva brenda mur guri me krah, llaç gëlqere 1:2

Sipërfaqja e suvatuar do të kontrollohet e gjitha duke evidentuar suvatimin e shkëputur, i cili do të priset deri në gur. Fillimisht do të kryhen stukimet, qepjet e çarjeve të mundshme dhe sistemimi i sipërfaqeve ku është i nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç gëlqere 1:2 me më shumë shtresa edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin. Përpara se të vendoset shtresa e suvasë duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Llaçi i suvasë nuk duhet të aplikohet në tm ≤5C.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2cm llaçi gëlqere 1:2, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirit me llaç me trashësi 15cm çdo 1 deri në 1,5m), dhe e lëmuar me mistri e përdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Llaç gëlqere ajrore duhet të ketë këto karakteristika :

- ❖ Kufiri i rezistencës në shtypje 25 kg/cm²,
- ❖ Pesha volumore 1800 kg/m³,
- ❖ Konsistenca, ≤8
- ❖ Papastërtia e rërës 12 %,
- ❖ Moduli, 1.8
- ❖ Raporti G:R 1:2

Rëra për suva duhet të jetë e përbërë nga kokriza të dimensioneve të tilla për të kaluar në sitë me përmasa 1mm.

Në këtë zë punimesh përfshihen çmimet që duhen për të realizuar sipas kushteve teknike riparimel e suvalimeve të mureve të jashtme të guri, përgulilja e sipërfaqes së murit pasirimi nga pluhuri, lagja, vendosja e shtresës së suvasë deri në tharje, dora e dytë, dhe finoja, skeleritë e nevojshme. Në çmim përfshihet blerja e të gjitha materialeve të nevojshme me cilësi, transporti i tyre, skeleri, përpunimi dhe vendosja në objekt, ngarkim shkarkimi dhe çdo punë që lidhet me të.

Ky çmim është për Lekë/ m².


4.20 Qepje murature me shufra inoksi injektuar me llac cemento M25

Ky proces do të bëhet i kombinuar: me qepje me materialin e llaçit të injektimit dhe qepje me shufra hekuri inoksidabël.

Qepja me materialin e vendit do të bëhet kur gjërësia e çarjes nuk i kalon 3 cm. Kur çarja është më e madhë se 3 cm (sidomos në kater qoshet e mureve të naosit) dhe në pamundësi të qepjes me materialin e vendit, do të përdoret qepja me shufra inoksidabel injektuar me llac cimenti M25.

Shufrat do të jenë min 50 cm në çdo krah të çarjes dhe anët do të ankorohen në strukturën e kupolës. Cdo çift shufrash do të vendoset min. 50 cm larg njëra tjetrës (rast pas rasi) gjatë

gjithë lartësisë së murit ku ka çarje vertikale. (Detaji i mëposhtëm: shembull përforcimi me shufra hekuri dhe injektim me llaç çimento)



4.21 Fugatim muri (pastrim + larje me ujë + fugatim)

Në punimet e konservimit të muraturave në pjesën më të madhe i takojnë punimeve të fugatimit. Fugat që do të nënshtrohen këtij procesi, do të evidentohen plotësisht vetëm pasi të jetë bërë pastrimi i vegjetacionit nga territori përreth dhe nga sipërfaqja e strukturës. Do të fugatohen të gjithë pjesët e muraturës, sipërfaqeve horizontale të strukturës ku ka vegjetacion si dhe pjesët ku materiali lidhës është i degraduar.

Pasi të pastrohet eliminohet vegjetacioni, muret do të shplahen me ujë në mënyrë që të ekspozohen llaçi dhe fugat. Pjesët ku ka pasur rrënjë si dhe në ato pjesë ku llaçi është i dobët do të pastrohen nga llaçi i degraduar me furçë të butë teli dhe pasi të pastrohen nga të gjitha mbetjet organike do të rimbushen me llaç të ri. Fugat duhet të mbushen deri në planin e murit, që të krijojë sipërfaqe të njëjtë me tipin e fugatimit të përdorur në teknikën origjinale të muraturës ekzistuese dhe që në asnjë rast të mos ndodhë mbajtja e ujit apo dherave që sjell era.

Llaçi duhet të jetë me gëlqere hidraulike në raportin 1 masë gëlqere hidraulike dhe 1 masë rërë e ashpër.

Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/m².

4.22 Pastrim i shtresës së gurit nga pluhuri dhe depozitimet sipërfaqësore me ujë me pompë me presion (idropulitrice)

Sipërfaqja e muraturës që do të qëndrojë e pasuvatuar duhet të pastrohet nga pluhurat dhe depozitimet sipërfaqësore. Pastrimi bëhet me pompë me ujë me presion, pastrimi duhet të bëhet duke rregulluar më parë presionin e ujit. Ky pastrim përveç depozitimeve sipërfaqësore bën edhe pastrimin e materialit të llaçit që mund të jetë shkëputur ose

plufurizuar në fuga midis gurëve. Pas këtij procesi mund të mbushen fugat në të cilat mund të ketë shkëputje të konsiderueshme të llaçit.

Ky çmim është për Lekë/ m².

4.23 Restaurim mur guri me llaç gëlqere 1:3 me teknikën shqep-qep

Fragmentet e mureve ekzistuese të palidhur me pjesën tjetër të strukturës, që duhen përforcuar për të vijuar me plotësimin e tyre, janë në gjendje rrezik shemje. Problemi është degradimi i materialit lidhës i cili ka sjellë rrëzime dhe formimin e çarjeve. Këto pjesë do të restaurohen me teknikën shqep-qep. Prishja do të bëhet pjesë-pjesë dhe mbas prishjes së një pjese do të puntelohet menjëherë (në varësi të seksionit që është i nevojshëm).

Me tej pjesë-pjesë hiqen pajantat çdo një metër dhe pasi pastrohet nga mbeturinat do të fillojë rindërtimi i murit. Lidhja ndërmjet dy pjesëve të murit do të realizohet edhe me vendosje e brezave të drurit në pjesën e re dhe lidhja me kushakë (breza tërthorë) me brezin e vjetër nëse ka. Materiali lidhës do të jetë llaç gëlqere 1:3. Rindërtimi i murit do të eliminojë dhe çarjet. Për kompaktësimin e murit mbas rindërtimit, do të jetë e nevojshme injektimi gjatë gjithë sipërfaqes së tij.

Ky çmim përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe jepet për njësi Lekë/m³.

4.24 Pastrim i qemereve dhe kupolave nga mbushja me llac i degraduar

Do të bëhet me kujdes duke pastruar mbeturinat e strukturës së llac cimentos mbi të dhe llaçin e dekompozuar të kupolës dhe muraturës së absidës, deri në thellësinë ku do të ndeshet llaç i mirë.

Ky çmim është për njësi Lekë / m³.

4.25 Fugatim në kupola dhe qemere

Në varësi të thellësisë së pastrimit, fugatimi do të bëhet me shtresa 5 cm. Hidhet një shtresë llaçi dhe mbasi ka fituar prezën kjo shtresë, hidhet shtresa e dytë, e kështu me radhë. Shtresa e fundit fërkohet me furçë teli, për të eliminuar plasaritjet.

Përbërja e llaçit të fugatimit:

Rërë lumi e larë	3 pjesë
Rërë vullkanike pluhur	2 pjesë
Pluhur tulle e çmërçi	½ pjesë

Gëlqere e vjetër

3 pjesë

Pasi të pastrohet e gjithë sipërfaqja e brezit do të vazhdohet me vendosjen e tirantave unazore inoxidabël të brendshme sipas projektit 2Ø 12 të pozicionuara në pllakat metalike të cilat mbështeten mbi nje brez llac horosan 10-15cm për fiksion.

4.26 Shtresë llaç horasan

Përbërja e llaçit horasan:

Rërë lumi e larë

2 pjesë

Rërë vullkanike me granulacion 0,5-1 cm

2 pjesë

Pluhur tulle e çmërçi dhe copa tulle deri në 2 cm

2 pjesë

Gëlqere e vjetër

3 pjesë

Pasi realizohen proceset e mësipërme të përgatitjes së llaçit horasan mund të vazhdohet me veshjen e kupolës së absidës, përpara se të vendosen rrasat e gurit. Procesi i punës do të zhvillohet sipas skicës/prerje 3/3 në fletët teknike.

Ky çmim është lekë/m³.

4.27 Prishje elementësh betoni qe janë realizuar (këmbanare, kolona, trarë, shtresa mbi sofat)

Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhëzohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjithë sipërfaqet e realizuara kohët e fundit me beton . Prishja do të bëhet në prezencë të Supervizorit të punimeve të restaurimit në mënyrë që të gjykojë shkallën e ndërhyrjes dhe prishjes si dhe të vlerësojë gjendjen origjinale. Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes ku do realizohet ndërhyrja dhe teknikën e ndërhyrjes . Gjatë procesit të prishjes duhet të kihet kujdes që të mos dëmtohen detajet arkitektonike .Sipërmarrësi do të heqë të gjitha copat dhe lëndët organike që rezultojnë nga prishjet në vendin e punës dhe do ti hedhin ato në përputhje me ligjet e shtetit, planin e menaxhimit mjedisor dhe me kërkesat e këtij specifikimi. Ky cmim përfshin tërësinë e punimeve që duhet për prishjen dhe heqjen e kujdesshme të zonave me beton të shtuara kohët e fundit, skeleri si dhe transportin e mbeturinave dhe ngarkim shkarkimi i tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

Ky çmim është lekë/m²

4.28 F.V dyer-dritare druri kasë binar teke xham



Dyert dhe dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërtesës. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (dimensionet) e tyre duhet të jetë sipas modelit origjinal. Dyert dhe dritaret do të prodhohen prej druri pishe, të stazhionuar, dhe imprenjuar dhe do të lyhen me vaj lini dy duar.

Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Në bazë të formës dhe përmasave të dritareve ekzistuese, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluar në të. Kanatë me xhama të pahapshme, të pajisur me doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikon, si dhe me kanata fikse.

Kujdes duhet treguar me përputhjen e kasave me hapësirat përkatëse si dhe të jenë të plotësuar me aksesore.

Vendosja e dyerve në vepër duhet të bëhet sipas kushteve teknike për montimin e tyre të dhëna në standartet shtetërore. Mënyra e vendosjes së tyre është në varësi të llojit të derës dhe materialit që përdoret për prodhimin e tyre. Për modelin e dyerve do t'i referohet modelit origjinal dhe konsultave në vend me supervizorin.

Kampione të artikujve të propozuar, do ti paraqiten paraprakisht mbikqyrësit të punimeve për aprovim paraprak.

Druri i pishës do të ketë këto karakteristika.

- Lagështi jo më tepër së 7-8 %,
- Peshë volumore 410-540kg/m³,
- Kufiri i rezistencës në tërheqje 130 MPa,

Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të sipërpërmendura, materialin drusor të përpunuar nga specialistët si dhe aksesoret, furnizimin dhe vendosjen në vepër, transportin dhe ngarkim shkarkimine tyre në vendet e përcaktuara nga Bashkia.

Ky çmim është për lekë/ m².

4.29 Përgatitje dhe vendosje lëndë e sharruar pishe

Ky zë përfshin përgatitjen dhe vendosjen e lëndës së sharruar të drurit në fasade aty ku brezi është tejet i degraduar dhe nuk e kryen më funksionin e tij statik. Lënda e drurit duhet të jetë trajtuar me dizinfektues ndaj krimbave e kërpudhave si dhe me do të trajtohen për rritjen e rezistencës ndaj agjentëve atmosferike. Lënda duhet të jetë e cilësisë së lartë dhe përpara se të vendosen në objekt lënda duhet të kontrollohet nga mbikëqyrësi i punimeve.

Brezat / arkitrarët e rinj që do të ndërtohen duhet të respektojnë modelin, dimensionet e brezave / arkitrarëve ekzistues. Përpara ripërdorimit të gjithë elementet do të vendosen duhet të trajtohen me antimolë e vaj lini. Materiali, ngjyra dhe dimensionet e elementëve të

rinj duhet të jenë të njëjtë me ata ekzistues. Në objekt, në bashkëpunim të mbikëqyrësit të punimeve dhe projektuesit të evidentohet dhe detajohet teknika e montimit të brezave /arkitkrave të rinj.

Ky zë pune përfshin të gjitha proceset e mësipërme dhe çmimi i tij është për njësi Lekë/ m³.

4.30 Sherbetosje e bojatisje me gëlqere

Ky zë parashikon lyerjen me gëlqere murit te brendshem te narteksit.

Fazat e ndërhyrjes:

Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet

Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e gëlqeres së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit dhe bërja gati për paralyerje.

Paralyerja e sipërfaqes së pastruar

Në fillim të procesit të lyerjes, bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqeren e holluar (Astari). Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg gëlqere me një liter uje. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m² sipërfaqe.

Lyerja me gëlqere e sipërfaqes

Lyerja bëhet me dy duar bojë gëlqere e stazhonuar mirë. Ky çmim përfshin tërësinë e punimeve të sipërpërmendura, transportin e materialit, skeleri.

Ky çmim është për Lekë/ m².

4.31 F.V Fikëse zjarri

Fikësit e zjarrit do te jene te tipit mobile

Fikësit e zjarrit janë komponente aktive të mbrojtjes kundër zjarrit. Nuk duhet harruar edhe komponenti pasiv që ne rastin tone eshte perberja drusore e elementeve te nderimit nuk na favorizon ne mbrojten kunder zjarrit.

Bombulat fikëse të zjarrit do te jene sipas normave/standardeve bashkëkohore DIN EN 2 :

Klasa A :

Përdoret për zjarre që rezultojne nga materiale të forta si psh.: Dru, letër, tekstile, plastike, etj



Sasia e bombulave fikëse duhet të vendoset sipas kërkesave të normave/standardeve bashkëkohore dhe moderne (psh DIN EN 3). Ata duhet të mirëmbahen dhe të kontrollohen të paktën çdo dy vjet nga autoritetet e licensuara.

Punimet të tjera: Punime elektrike

Punimet elektrike konsistojnë në një rehabilitim total duke i zëvendësuar instalimet e vjetra në përputhje me normat dhe kushtet teknike të zbatimit. Në projekt do të parashikohen pajisjet e nevojshme dhe të domosdoshme sipas ngarkesës dhe parametrave teknik. Në këtë çmim përfshihet tërësia e punimeve, blerja e transporti i materialeve, vendosja e tyre dhe prova me ngarkesë pas përfundimit (shtrirjen e telave e kabllave të ndryshme për realizimin e instalimeve në standarde bashkëkohore, ccelësa, priza, llampa, portollamba, te cilat do të instalohen nëpërmjet kutive shpërndarëse të paravendosura në mur, kutive të automateve me llamba sinjali etj), si edhe punim tjetër të nevojshëm për të përfunduar me sukses punimet elektrike.

Gjithcka do të jetë sipas normales C.E.I sipas ccertifikatës normale konforme .

Të gjitha telat dhe kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës.

Telat duhet të jenë përçues të thjeshtë bakri të izoluar (veshura) me shtresë teke PVC për tu futur brenda tubave dhe linjave. Izolimi i telave dhe këllëfi duhet të jenë me izolim të ngjyrosur për të identifikuar fazën dhe nulin. Të gjitha rastet kur kabllot PVC përfundojnë në një panel shpërndarës siguresash, pajisje elektrike etj, duhet lënë një sasi kablli të lirshëm

për të lejuar në të ardhmen, zhveshjen e rilidhjes me terminalët pa shkaktuar tërheqje të tyre. Kabllot për çdo seksion të instalimit duhet të mbyllen nëpër tuba dhe në sistemin e kutive futëse përmbledhëse për atë ndarje të veçantë. Zhveshja e izolimit në kabllot e izoluar me PVC duhet të kryhet duke përdorur një vegël të përshtatshme për zhveshjen, dhe jo një thikë. Kanalet dhe aksesorët Instalime elektrike të bëhen të maskuara të futura në tuba PVC fleksibël.

Punimet elektrike do të përfshijnë vendosjen e kanalave metalike për futjen e kabllave elektrikë. Gjithashtu është parashikuar një luadër ndricimi dhe sistem i ri siguresash

Kanalinë metalike 150 x50 (2.a-121)

Sistemi i kanalave është shumë i përdorshëm sidomos në rikonstrukcione kur sistemi i vjetër elektrik duhet të nxirret komplet jashtë pune dhe duhet të instalohet një i ri pa dëmtuar suvatimin ose dhe në ndërtime me materiale të zmontueshme.

Sistemet e kanalave duhet të jenë të serisë NP 40/42 të prodhuara nga GEEISS-ITALY ose pranohet një tjetër i ngjashëm sipas standarteve përkatëse.

Sistemi i kanalave përbëhet nga aksesorët e tij si:

- Kanalet me dimensione të ndryshme, në varësi të numrit të telave/kabllave, prizave, çelësave etj., që do të instalohen në të, gjatësia 2 m
- Këndorët (shërbejnë për formimin e këndeve në instalime) të cilat janë në varësi të kanalit që po shtrihet
- Devijuesit në formë T
- Kutitë shpërndarëse të dimensioneve të ndryshme

Montimi i kanalave bëhet me anë të vidave, dhe vendoset 0.4 m nën nivelin e tavanit, për rrjetin shpërndarës dhe në lartësinë e prizave/çelësave për montimin e tyre.

F.V. Automat sekondar me 4 vende (2.490/a)

Panelet e shpërndarjes në kate janë pika shpërndarje të TU, të cilat përveç shpërndarjes së tensionit për katin, bëjnë të mundur edhe selektimin e mbrojtjes.

Këto panele janë të tipit që montohen nën suvatim ose mbi suvatim.

Panelet në varësi të ngarkesës mund të jenë deri në 12 elementë për një kat dhe më tepër elementë për 2 kate, e kështu me rradhë.

Këto panele, meqënëse do të vendosen në ambiente publike shkolla / kopshte, duhet të jenë të mbyllshëm me çelës për arsye sigurie.

Elementët e domosdoshëm të këtyre paneleve janë:

- Automati kryesor 3 fazor manjetotermik dhe me mbrojtje diferenciale, amperazhi varet nga ngarkesa;
- Sinjalizuesit e fazave (3 copë);
- Automatët manjetotermik njëfazorë të fuqisë (prizave), të cilët në varësi të prizave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;
- Automatët manjetotermik të ndriçimit, të cilët në varësi të ndriçuesave që do të furnizohen kanë edhe amperazhin e tyre;

Rekomandohet që sistemi i ndriçimit të jetë i ndarë nga ai i fuqisë.

Shembuj figurativë të këtyre paneleve janë paraqitur më poshtë, dhe janë të prodhimit GEËISS, Itali, seria 40 CD. Rekomandohet të përdoren ata ose të ngjashëm me ata që plotësojnë të njëjtat kushte.

F.V. Siguresa ~ 25A (2.489)

Siguresat (Automatet) janë ndarës qarku, të cilat veprojnë në mënyrë automatike në raste mbingarkesash dhe e hapin qarkun duke i ndërprerë tensionin ngarkesës. Për këtë në përzgjedhjen e amperazhit të automatëve duhet të merret parasysh ngarkesa që ai mbron.

Automatët që përdoren në ambientet publike janë manjetotermik dhe me mbrojtje diferenciale.

Automatët janë njësi mbrojtje nga mbingarkesat. Ato vendosen në kutitë e çelësave automatë, në panelët e kateve dhe në panelin kryesor të TU.

Automatët sipas numrit të fazave që ato mbrojnë i ndajmë në: një fazor dhe në trefazor.

Sipas amperazhit i ndajmë: 6 A; 10 A; 16 A; 20 A; 25 A; 32 A

Automatët i ndajmë sipas numrit të poleve: një polësh, dy polësh, tre polësh dhe katër polësh.

Në figurën e mëposhtme paraqitet një grup automatësh, si dhe shembuj individual të disa tipeve të prodhimit GEWISS – Itali, rekomandohet përdorimi edhe i automatëve të ngjashëm.

F.V. Kasetë plastike KE me 6 modular (vende) (2.490/b)

Kutitë e çelësave automatë janë panele elektrike për ambiente të veçanta, njëloj si panelet e kateve, me ndryshimin që numri i elementeve është i reduktuar.

Këto kuti përdoren zakonisht në ambientet e banjo-dusheve, në laboratorët e ndryshëm të shkollës, në sallat e koferencave etj.

Në ambientet e banjo-dusheve në të cilat janë montuar edhe boilerë, duhet që patjetër të vendosen këto kuti dhe në përbërje të tyre të jetë një rele diferenciale, si dhe automatë të veçantë për çdo boiler dhe për ndriçimin.

Në figurat e mëposhtme paraqiten disa tipe të kutive të automateve të cilat i përkasin prodhimit GEWISS, Itali dhe rekomandohet të përdoren ato ose një prodhim i ngjashëm.

Montimi i kutive mbi suvatim bëhet me anë të vidave me upa, ndërsa ato nën suvatim fiksohen me allçi e suvatim dhe s' duhet të dalin mbi nivelin e suvatimit.



Përgatitën, specialistë të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore

Ark. Artila Vavako

Ark. Arben Spaho

Ark. Jora Vokopola

